



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština -Municipality of Prishtina

---

**E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T**  
**të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më**  
**19.02.2014, e cila filloi në orën 15:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës dhe u.d. i drejtorit të Drejtorisë së Ekonomisë dhe Zhvillimit, Halim Halimi, kryesues, Sami Hamiti, Hazir Borovci, Yll Hoxha, Hatixhe Hoxha, Islam Pacolli, Imer Rusinovci dhe Cuneyd Ustaibo.

**Morën pjesë edhe:** Agim Salihu, shef i Zyrës ligjore, përfaqësuesi i OSBE -së, përfaqësuesi i INPO-së, Premtime Preniqi, koordinatorë për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore dhe përfaqësuesit e mediave.

Mbledhjen e kryesoi dhe e udhëhoqi **Halim Halimi**, kryesues i komitetit.

Njëzëri u miratua ky

**REND DITE :**

1. Propozimi i Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2014;
2. Propozimvendimi për formimin e Komitetit për Komunitete;
3. Caktimi i anëtarit në Komisionin komunal të aksionarëve në ndërmarrjet publike lokale;
4. Propozimvendimi për vazhdimin e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës AKP-së;
5. Propozimvendimi për caktimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës;
6. Propozimvendimi për shitjen e pronës së luajtshme të Komunës;
7. Informatë për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2013 / 2014;
8. Propozimvendimi për lejimin e mjeteve NPK "Trafiku Urban" SH.A. Prishtinë;
9. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Memorialit, në shenjë nderimi për kontributin e gruas gjatë periudhës së Luftës 1998-1999;
10. Propozimvendimi për ndryshimin e Statutit të teatrit të qytetit të Prishtinës "Dodona";
11. Propozimvendimet përfundimtare për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës;
12. Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
13. Të ndryshme.

Para se të fillonin me diskutimet rreth pikave të rendit të ditës, **Dardan Sejdiu** tha se për temat që do të diskutohen, e që kanë të bëjnë me drejtoritë, unë do t'i përfaqësojë ato.

**Kryesuesi** theksoi se është mirë që edhe drejtorët të jenë të pranishëm në mbledhje, kur në rend dite ka ndonjë pikë që ka të bëjë me atë drejtori.

## **Pika e parë**

**Lidhur me Propozimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2014,** kryesuesi tha se Kuvendi i Komunës në mbledhjen e kaluar e ka formuar një grup punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Prishtinës për vitin 2014. Ky është një plan orientues, andaj kryetari, sipas nevojës, mund të shtojë edhe pika të tjera të rendit të ditës.

**Sami Hamiti** tha se Grup parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar këtë plan të punës, dhe sugjeron disa plotësime që janë funksionale:

- Mbledhja e muajit shkurt, pika e dytë, bartja e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2013 në vitin 2014, të jetë pikë e rendit të ditës në muajin mars;
- Mbledhja e muajit mars, pika e tretë, shqyrtimi i raporteve të komisioneve komunale të aksionarëve të NPL-ve për vitin 2013, duhet të jetë edhe informimi i punës për vitin 2013.
- Mbledhja e muajit qershor, pika e parë, raporti gjashtëmuor i Kryetarit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare të Komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës, të jetë pikë e rendit të ditës në muajin korrik.

**Yll Hoxha** propozoi që për mbledhjen e muajit qershor, rreth çështjes së arsimit, në rend dite të jetë një debat lidhur me cilësinë e arsimit në komunën e Prishtinës. Po ashtu të kemi edhe raportet e ndërmarrjeve publike lokale, në mënyrë që të shihet se sa janë përmbushur synimet e komisionit të aksionarëve.

**Kryesusi** tha se është paraparë që për muajin shtator të jetë informata për suksesin e nxënësve, përfundimin e vitit shkollor 2013/2014 dhe fillimin e vitit shkollor 2014/2015.

**Sami Hamiti** tha se cilësinë në arsim e mbikëqyr niveli qendror.

**Islam Pacolli** shprehu mendimin se për matjen e cilësisë së arsimit nuk jemi ne, por janë institucionet përkatëse. Sa i përket ndërmarrjeve publike lokale, kur të zgjidhen anëtarët e komisioneve të aksionarëve, duhet të bëjnë një raport të punës së tyre.

**Kryesusi** tha se ne nuk mund ta bëjmë vlerësimin e cilësisë në arsim. Për këtë çështje kompetente është Ministria e Arsimit.

**Imer Rusinovci** propozoi që për mbledhjen e qershorit të jetë një informatë për vijueshmërinë në shkolla.

**Dardan Sejdiu** propozoi që në muajin qershor, pikë e rendit të ditës të jetë diskutimi për politikën publike programore të arsimit në komunën e Prishtinës. Sa i përket ndërmarrjeve publike lokale, ekziston një obligim ligjor, se këta anëtarë të aksionarëve duhet të raportojnë për punën e tyre, sepse ata janë përgjegjës për pronën e Komunës.

**Yll Hoxha** shprehu mendimin se përfaqësuesit e Kuvendit të Komunës në këto ndërmarrje publike lokale, nuk i kanë përmbushur detyrat dhe obligimet e tyre.

**U konstatua se njëzëri u përkrah propozimi i Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2014, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

## **Pika e dytë**

Lidhur me propozimvendimin për formimin e Komitetit për Komunitete, kryesuesi tha se ky komitet përbëhet prej 9 anëtarëve.

Për anëtarë të Komitetit për Komunitete u propozuan:

1. Sylejman Pireva, përfaqësues i shumicës,
2. Hetem Kupina, përfaqësues i shumicës,
3. \_\_\_\_\_, përfaqësues i shumicës,
4. Nenad Miladinoviq, përfaqësues i komunitetit serb,
5. Dejan Miladinoviq, përfaqësues i komunitetit serb,
6. Oktaj Kurtesh, përfaqësues i komunitetit turk,
7. Fitneta Kandiç, përfaqësuese e komunitetit boshnjak,
8. Idriz Berisha, përfaqësues i komunitetit ashkali dhe
9. Adnan Ajeti, përfaqësues i komunitetit rom.

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për formimin e Komitetit për Komunitete, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

## **Pika e tretë**

Lidhur me caktimin e anëtarit në Komisionin komunal të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale, kryesuesi tha se emrat e anëtarëve të komisioneve të aksionarëve në ndërmarrjet publike lokale do të publikohen në mbledhjen e Kuvendit.

**U konstatua se njëzëri u përkrah caktimi i anëtarit në Komisionin komunal të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

## **Pika e katërt**

Lidhur me Propozimvendimin për vazhdimin e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim AKP-së, informoi **Agim Salihu**, i cili tha se Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në bazë të Vendimit 01. nr. 46-3714, të dt. 31.1.2012, ia ka dhënë lokacionin në shfrytëzim të përkohshëm Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP). AKP-ja ka kërkuar që t'i miratohet kërkesa për vazhdimin e shfrytëzimit të pronës edhe për dy vjet, ku në Këshillin e Drejtorëve është propozuar që prona t'i jepet në shfrytëzim në kohëzgjatje prej dy(2) vitesh në shfrytëzim me qira.

**Islam Pacolli** propozoi që prona komunale t'i jepet në shfrytëzim AKP-së për një vit, me mundësi vazhdimi, por me paralajmërim tre muaj më parë.

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për vazhdimin e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim AKP-së dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

## **Pika e pestë**

Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, **Agim Salihu** tha se ky komisioni duhet t'i ketë shtatë (7) anëtarë, tre (3) nga të cilët i cakton Kryetari i Komunës, tre (3) anëtarë propozohen prej subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend, ndërsa një (1) anëtar propozohet nga shoqëria civile.

Për anëtarë të Komisionit të caktuar nga Kryetari, u propozuan :

1. Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës dhe u.d. i drejtorit të Drejtorisë së Ekonomisë dhe Zhvillimit;
2. Nora Kelmendi, drejtoreshë e Drejtorisë së Kadastrit;
3. Besnik Bislimi, u.d. i drejtorit të Drejtorisë së Financave dhe Pronës;
4. Sokol Krasniqi, anëtar i Kuvendit;

**Kryesuesi** tha se emrat e anëtarëve të tjerë të komisionit mbetet që të sillen në Kuvend.

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për caktimin e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

## **Pika e gjashtë**

**Sami Hamiti**, lidhur me Propozimvendimin për shitjen e pronës së luajtshme të Komunës, tha se nuk është përfillur një procedurë ligjore, andaj konsideromë se është e paarsyeshme që në Kuvend të prezantohet për shitje vetëm një veturë, "Audi Q - 7", kur ka edhe vetura të tjera që duhet të shiten. Konsiderojmë se ky vendim është politik dhe arsyetimi është i mangët, andaj nuk jemi që kjo pikë e rendit të ditës të shkojë për shqyrtim në Kuvend.

**Yll Hoxha** tha se nga vet fakti që kryetari e ka mbajtur premtimin dhe e ka sjellë propozimin për shitjen e veturës, është e arsyeshme dhe e domosdoshme shitja e saj.

**Islam Pacolli** tha se është dashur të qiten në shitje edhe veturat tjera. Me këtë formë të procedimit, ne jemi kundër shitjes.

**Imer Rusinovci** propozoi që vetura të mos shitet, të mbahet për çështje protokollare, në veçanti për udhëtime jashtë vendit.

**Cyneyd Ustaibo** propozoi që vetura të mos shitet.

**Hatixhe Hoxha** tha se më mirë të shitet kjo veturë dhe të shfrytëzohen këto mjete për nevoja të tjera, por të përfshihen në listë edhe veturat tjera për shitje.

**Hazir Borovci** tha se paraprakisht duhet t'i referohemi ligjit. Mendoj se kemi disa lëshime ligjore, ku na mungon vlera blerëse e saj, zhvlerësimi i deritanishëm, por edhe arsyetim i këtij propozimvendimi është i mangët. Kërkojmë sqarime shtesë lidhur me këto çështje. Pra, jemi kundër shitjes së këtij automjeti.

**Dardan Sejdiu** tha se një veturë që nuk do të përdoret për 4 vjet, ajo do të amortizohet dhe do t'i ulet vlera edhe më shumë duke qëndruar në garazhin e Komunës. Sa i përket veturës për protokoll, ne e kemi një veturë tjerë për protokoll.

**Yll Hoxha** tha se kjo është temë publike, e cila duhet të diskutohet në Kuvend, andaj mbetet që ta vlerësojë Kuvendi se vetura duhet apo nuk duhet të shitet.

**Dardan Sejdiu** tha se në mbledhjen e ardhshme të KPF-së do të sjellim listën e veturave të tjera për shitje.

**Duke pasur për bazë diskutimet e parashtruara, u vlerësua se shitja e veturës nuk është e ngutshme, por ajo mund të shitet me automjetet tjera, për të cilën arsye (5) anëtarë ishin që shitja e kësaj veture të bëhet së bashku edhe me automjetet e tjera që do të jenë për shitje, kurse tre (3) anëtarë të komitetit ishin që kjo veturë të shitet menjëherë.**

#### **Pika e shtatë**

Informata për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2013 / 2014. **Sami Hamiti** tha se, përveç kësaj informate që ka të bëjë me suksesin e nxënësve, propozoj që në Kuvend të diskutohet edhe rreth gjendjes së furnizimit me naftë për institucionet shkollore.

**U konstatua se njëzëri u përkrah Informata për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2013 / 2014 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.**

#### **Pika e tetë**

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për lejimin e mjeteve NPK "Trafiku Urban" SH.A. Prishtinë dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

#### **Pika e nëntë**

**Agim Salihu** informoi lidhur me Propozimvendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Memorialit, në shenjë nderimi për kontributin e gruas gjatë periudhës së Luftës 1998-1999. Ai tha se ky është vendim i propozuar gjatë mandatit të kaluar, i cili është shqyrtuar në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve të mandatit të kaluar, por tash për tash nuk e kemi materialin e gatshëm.

**Anëtarët e Komitetit u pajtuan që kjo pikë të shtyhet derisa të kompletohet materiali dhe të shqyrtohet në njërën nga mbledhjet e radhës së Komitetit për Politikë dhe Financa.**

#### **Pika e dhjetë**

**Agim Salihu** informoi për Propozimvendimin për ndryshimin e Statutit të teatrit të qytetit të Prishtinës "Dodona", duke thënë se është propozuar që të plotësohet dhe ndryshohet dhe ky ndryshim të jetë në harmoni me legjislacionin në fuqi. Plotësimi dhe ndryshimi do të jetë në nenin 5, paragrafi 5, i cili duhet të plotësohet si në vijim: "Emërtimi, logoja dhe vula e institucionit duhet të jenë në gjuhët zyrtare sipas Ligjit për përdorimin e gjuhëve".

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimin për ndryshimin e Statutit të teatrit të qytetit të Prishtinës "Dodona" dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

## **Pika e njëmbëdhjetë**

Lidhur me Propozimvendimet përfundimtare për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, informoi **Agim Salihu**. Është fjala për dy vendime të natyrës së njëjtë, e që duhet të procedohen më tej.

**Sami Hamiti** kërkoi që për shqyrtimin e këtij materiali t'i bashkëngjiten vetëm dokumentet e nevojshme.

Me qëllim të trajtimit të këtyre dy pikave, **Yll Hoxha** kërkoi që të gjithave grupeve parlamentare t'iu sillen të gjitha dokumentet e nevojshme për shqyrtim. Pra, duhet ditur edhe motivin e ndërrimit të pronës.

**Me pesë (5)vota për dhe tre (3) kundër, u konstatua se u përkrahën Propozimvendimet përfundimtare për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe i dërgohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

## **Pika e dymbëdhjetë**

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

## **Të ndryshme**

**Yll Hoxha** kërkoi që të definohet çështja lidhur me zgjedhjen e anëtarëve në Komisionin komunal të aksionarëve në ndërmarrjet publike lokale.

**Sami Hamiti** tha se zgjedhja e anëtarëve në komisionin komunal të aksionarëve është çështje votimi të shumicës në Kuvend, pra është e drejtë e subjekteve politike me i prezantuar emrat e anëtarëve të propozuar.

**Islam Pacolli** propozoi që të bëhen listat nga subjektet politike dhe të qiten në votim.

**Hazir Borovci** shprehu mendimin se duhet të bëhen listat dhe të prezantohen me propozimet e dhëna nga subjektet politike. Po ashtu kërkoi të dijë se me rastin e 6-vjetorit, Ditës së Pavarësisë së Kosovës, a ka pasur ndonjë organizim për vizita te varrezat e dëshmorëve dhe propozoi që herëve të tjera, mos t'i shpëtojë Komunës së Prishtinës që me rastin e datave, historike të mos bëjë organizimin e vizitave te varrezat e dëshmorëve.

**Dardan Sejdiu** tha se manifestimin për 6-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës e ka organizuar niveli qendror.

**Kryesusi** shprehu mendimin se duhet analizuar se si të veprojmë me rastin e shënimit të datave historike.

*Mbledhja përfundoi në ora 17:20.*

**Procesmbajtës :**  
**Zijadin Gashi**  
**Shyhrete Islami**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Halim Halimi**